



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezimi Prilazja / Protokoll Received / Delivered	08 - 11 2022	2	viti god year
Organ / Njesia Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHAK	6919/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.663/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjyimit me numër A.nr.2490/2021 të datës 26.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, te pranuar me date 10.10.2022 ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.663/2021 të datës 16.07.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë

kundër organit të punësimit-Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 08.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.663/2021 e datës 16.07.2021 e parashtruar nga ankuesja

II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër 01nr.120/02-15932 i datës 16.06.2021 i Kryetarit të Komunës së Gjakovës.

III.OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Gjakovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e tij, duke bërë kompensimin e pagës prej 50% për ankuesen prej datës 21.04.2016 deri me datë 08.01.2021.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses _____, punësuar në Komunën e Gjakovës sipas Akt Emërimit me numër 01-112-143/5 të datës 12.03.2012 në pozitën "Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Pronësore Juridike", në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Kryetari i Komunës së Gjakovës me datë 21.04.2016 ka nxjerrë Vendim me numër 01nr.116-21952/2016, me të cilin ka bërë pezullimin parandalues me 50% të pagës deri në vendimin përfundimtar nga gjykata.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda me Aktgjykimin PKR.nr.309/14 të datës 21.03.2019, e ka liruar nga akuza ankueset cili Aktgjykim me datë 11.02.2020 është bërë i plotë-fuqishëm me të cilin theksohet se nuk është provuar që e njëjta ka kryer vepër penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar.

Kryetari i Komunës së Gjakovës me datë 17.12.2020 ka nxjerrë Vendim me numër Nr.01-112/02-30379 me të cilin ankuesen e ka sistemuar /e ka kthyer në vendin e punës "Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Pronësore Juridike", në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, në Komunë të Gjakovës, të cilin vendim ankuesja e ka pranuar me datë 06.01.2021.

Ankuesja më datë 20.05.2021 ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 01-120/02-12710 tek Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, pas kthimit në vendin e punës, për shkak të mos kompensimit të pagës prej 50 %, me rastin lirim nga akuza sipas Aktgjykimit me numër PKR.nr.309/14 të datës 21.03.2019, i plotë-fuqishëm me datës 11.02.2020.

Kryetari i Komunës së Gjakovës me datë 16.06.2021, ka nxjerrë Vendimin me numër 01 nr.120/02-15932, me të cilin e ka refuzuar kërkesën e datës 20.05.2021 të ankueses, për mos kompensimin e 50% të pagës së ndaluar, nga data 21.04.2016 me rastin e pezullimit parandalues të marrëdhënies së punës të ankueses të kërkuar deri me datë 08.01.2021, duke u bazuar në dispozitën transitorë të Ligjit Nr.06L-114 për Zyrtarët Publik, me arsyetimin se dispozita nuk përcakton zbatimin e Ligjit për Shërbimin Civil, për kompensimin e 50% të pagës me rastin e pezullimit parandalues të ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit të datës 16.06.2021 të Kryetarit të Komunës së Gjakovës, ka parashtruar ankesë me datë 16.07.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokolli 3774/2021, me pretendime ankimore që Komuna e Gjakovës, t'i bëjë kompensimin e ndalesës së pagës prej 50% se bashku me kamatat ligjore, tatimet ne page dhe kontributet pensionale nga data 21.04.2016 deri më datë 08.01.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.07.2021, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Gjakovës. Ndërsa Këshilli më datë 12.08.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Gjakovës ,e provat e bashkangjitura të datës 28.10.2022.

Këshilli, në mungesë të kuorumit për vendosje, më datë 01.09.2021, e ka njoftuar ankuesen lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtën që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Ankuesja, në mungesë të kuorumit për vendosje ka ndjekur procedurat gjyqësore dhe si rrjedhojë ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 26.09.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.2490/2021, i pranuar në Këshill me date 10.10.2022, me të cilin Aktgjykim e ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e datës 16.07.2021 të parashtruar nga ankuesja.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Aktgjykimi me numër A.nr.2490/2021 të datës 26.09.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesa me numër protokolli 3774/2021 e datës 16.07.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të parashtruar për mes postës së Kosovës të datës 14.07.2021 me numër R9050608; Vendimi me numër 01nr.116-21952 të datës

21.04.2016 për pezullim parandalues të ankuesit; Vendimi me numër 01nr.120/02-15932 të datës 16.06.2016 i Kryetarit të Komunës së Gjakovës, për refuzimin e kërkesës, se datës 20.05.2021; Aktgjykimin A.nr.2490/2021i datë 21.03.2019 i Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Pliko/zarf e datës 14.07.2021 R9050608; Përgjigje në ankesë e datës 12.08.2021 nga Komuna e Gjakovës, me pliko/zarf të datës 10.08.2021 me numër postar R1626378; Akte emërimi i datës 12.03.2012; Vendimi me numër 01nr.116-21952 i datës 21.04.2016 për pezullim parandalues, i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Gjakovës; Vendimi me numër 01nr.120/02-30379 i datës 17.12.20120 për sistemimin e ankueses, i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Gjakovës; Flete kthese e datës 30.12.2020 e nënshkruar me datës 06.01.2021; Flete kthese e datës 22.06.2021 e nënshkruar e pranuar me datës 24.06.2021 nga ankuese Vendimin me numër 01nr.120/02-15932.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses **është e bazuar, SEPSE:**
Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që ti bëhet kompensimi i 50% e pagës së ndaluar nga pezullimi parandalues respektivisht nga data 21.04.2016 deri me datë 08.01.2021, lidhur me këtë pretendim Kolegji ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës dhe ka konstatuar se ankuesja në bazë të Vendimit me numër 01nr.116-21952/2016 tw datës 21.04.2016, ka qenë e pezulluar nga puna me 50% të pagës për shkak se ndaj ankueses kishte filluar procedure penale se ka kryer vepër penale gjate ushtrimit të detyrës zyrtare, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që Komuna e Gjakovës t'i bëj kompensimin e ndalesës së pagës prej 50%, si dhe në bazë tw dëshmime tw ofruara ka konstatuar se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda me Aktgjykimin PKR.nr.309/14 të datës 21.03.2019 e ka liruar nga akuza ankuesen i cili Aktgjykim me datë 11.02.2020 është bërë i plotë-fuqishëm ku theksohet se nuk është provuar që e njëjta ka kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, andaj bazuar në këtë meqenëse akuza ndaj ankueses nuk është vërtetuar respektivisht është refuzuar, atëherë, sipas nenit 69 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *"Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës"* Periudha e mungesës do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi", rrjedhimisht në bazë të këtij paragrafi të këtij neni periudha e mungesës në punë do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi e që në rastin konkret Komuna e Gjakovës bazuar në dispozitën e cekur si më lartë, është e obliguar që ankueses ti bëjë kompensimin e mbetur edhe të 50% të pagës nga data e pezullimit parandalues .

Kolegji për shqyrtimit dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se pretendimi i lartcekur i ankueses është i bazuar, kështu që Komuna e Gjakovës respektivisht Kryetari i Komunës së Gjakovës është i obliguar që t'i bëj kompensimin e pagës prej 50% prej datës 21.04.2016 kur është nxjerr Vendimi me numër 01nr.116-21952/2016 për pezullim parandalues prej 50% të pagës për ankuesen, deri më datë 08.01.2021 kur ankuesja është kthyer në punë sipas Vendimit me numër Nr.01-112/02-30379 tw datës 17.12.2021, duke ja kompensuar edhe tatimin në pagë dhe trustin pensional.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, po ashtu konstaton se me datë 11.09.2019 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji me datë 25.11.2019 është pezulluar me vendimin Nr. ref.:VVMP 1525/20 për Masë të Përkohshme nga Gjykata Kushtetuese. Pas

vendosjes se masës së përkohshme të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, të gjitha institucionet publike kanë aplikuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil deri më datë 09.07.2020 kur ka hyrë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, rrjedhimisht Kryetari i Komunës së Gjakovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 01nr.120/02-15932 te datës 16.06.2021, me te cilin vendim e ka refuzuar kërkesën e ankueses për kompensimin e 50% të pagës së mbetur, pas kthimit në vendin e punës sipas Vendimit tw datës 17.12.2020, konform Aktgjykimit me numër PKR.nr.309/14 të datës 21.03.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Krime të Rënda, i plotfuqishëm nga data 11.02.2020, me të cilin ankuesja është liruar nga akuza ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, sepse ne rastin e ankueses Kolegji konstaton se kanë qenë në fuqi dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës respektivisht ky ligj ka qenë i zbatueshëm deri me datë 08.07.2020.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.663/2021

Avdyl BEKTESHI

Bekteshi
Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

M. Gashi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.